	Emri i institucionit: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT	Dokumenti Nr.: RC/DS/117	
	Titulli: Plani strategjik i biznesit për DPS/KT	Versioni: 01	Faqe Nr.: Faqe 1/3

PSB, 24.11.2021

Titulli i DPS/KT:

DPS/KT 249 “Plastikë”

A Historiku

DPS/KT 249 është krijuar në 14.02.2002, në përputhje me Ligjin Nr.9870 “Për Standardizimin”, i ndryshuar dhe rregulloret e brendshme të DPS në përputhje me rregulloret/udhëzuesit dhe strategjitë e CEN/CENELEC dhe ISO/IEC, mbi krijimin dhe funksionimin e Komiteteve Teknike.

Fusha e këtij KT është adoptimi i standardeve evropiane dhe ndërkombëtare CEN/ISO si dhe hartimi i standardeve shqiptare në lidhje me standardizimin e nomenklaturës, metodave të provës, specifikimet e aplikueshme të materialeve dhe produkteve në fushën e plastikës. Brenda fushëveprimit të këtij KT një rëndësi e veçantë i jepet dhe metodave të provës, testimit të produkteve dhe industrisë së plastikës.

B Mjedisi i biznesit

B.1 Të përgjithshme


Puna e DPS/KT 249 vazhdon me një ritëm të shpejtë për shkak pasi plastikat janë një nga materialet më të rëndësishme dhe të gjithanshëm në vendin tonë. Ato mund të jenë të dizenuara për të qenë të qëndrueshme, të forta, të lehta dhe të rezistente ndaj kimikateve. Plastika mund të jenë izolues ose përçues të nxehtësisë, transparente, të tejdukshme ose jo, elastike dhe mund të jenë të fabrikua pothuajse në çdo formë dhe madhësi. Plastika është një material i shekullit të 21-të që fuqizon përmirësimin e mirëqenies njerëzore dhe është inovativ në zhvillimet për të përballuar sfidat e shoqërisë. Në veçanti, plastika lehtëson efikasitetin e burimeve dhe mbrojtjen e klimës. Industria e plastikës është një kontribues i madh në kontekstin e ekonomisë së gjelbër.

B.2 Treguesit sasiore të mjedisit të biznesit

Përdoruesit e standardeve të adoptuara nga DPS/KT 249 përfshijnë një shumëllojshmëri të subjekteve të tilla si furnizuesit e lëndëve të para, përpunuesit, tregtarët, prodhuesit, shitësit, ricikluesit, industrinë e lidhura me këtë fushë, konsumatorët, organizmat certifikues, laboratorët, organizmat qeveritare, kompani të ndryshme dhe Autoritetet Kombëtare të Inspektimit.

Standardet e adoptuara nga ky KT kanë përdorim të gjerë dhe synojnë

- përmirësimin e cilësisë së produktit;
- kontrollin e prodhimit;
- sigurinë e cilësisë;
- përmirësimin e konkurrencës;
- ndihmën në globalizimin e ekonomisë;
- zhvillimin e industrisë së plastikës në vendet e zhvilluara duke u bazuar në ekonomi.

	Emri i institucionit: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT	Dokumenti Nr.: RC/DS/117	
	Titulli: Plani strategjik i biznesit për DPS/KT	Versioni: 01	Faqe Nr.: Faqe 2/3

C Përfitimet

Puna e DPS/KT 249 duhet të rezultojë në adoptimin e standardeve që do të mundësojnë:

- zhvillimin e industrisë së plastikës, që kryesisht kanë të bëjnë me standardizimin e nomenklaturës, metodat e provës, përcaktimin e materialeve plastike, karakteristikat dhe vetitë e materialeve plastike, metodat e përditësuara të testimit, lehtësimin e lidhjes midis prodhuesve, konsumatorëve dhe organeve përgjegjëse për inspektimin dhe testimin teknik;
- mbështetjen për legjislacionin evropian;
- zhvillimin e mëtejshëm të standardeve ndërkombëtare dhe evropiane të cilat shërbejnë në industrinë e riciklmit të plastikës për të pasur një pasqyrim më të qartë.

D Pjesëmarrja në DPS/KT 249

Në DPS/KT 249 ka përfaqësues nga subjekte private, Shoqata e Konsumatorit Shqiptar, ekspertë të fushës, kompani riciklimi, dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë e cila merret me matjet dhe përbën një nga komponentët e infrastrukturës së cilësisë të nevojshme në ç' do vend të zhvilluar pasi ka një ndikim të rëndësishëm tek standardet, rregulloret teknike dhe vlerësimin e konformitetit si dhe luan një rol themelor në mbrojtjen e konsumatorëve dhe rritjen e cilësisë së jetës të qytetarëve. Palët e interesuara në raste të veçanta për probleme specifike mund të emërojnë ekspertët e tyre në grupet e punës të ngritura nga KT për çështje specifike.

E Objektivat dhe strategjitë

E.1 Objektivat e përcaktuara nga DPS/KT 249

- Miratimi i standardeve, në përputhje me procedurat për hartimin dhe adoptimin e standardeve shqiptare dhe dokumentet e tjera të standardizimit, në lidhje me metodat e provës të produkteve të plastikës dhe në lidhje me standardet e plastikës që mbulohen nga ky KT duke përgatitur çdo vit programin e punës së KT;
- Përfaqësimi i interesave kombëtare në organizmat evropiane dhe ndërkombëtare kur ajo kërkohet;
- Aplikimi i parimeve themelore të standardizimit;
- Zhvillimi i industrisë së plastikës dhe aktorëve të saj;
- Përditësimi i metodave të reja në këtë fushë dhe standardet e reja;
- Progres të vashdueshëm në standardet të cilat kanë parim riciklimin dhe përpunimin e plastikës.

E.2 Strategjitë e përcaktuara për arritjen e objektivave

Përmbushja e objektivave të DPS/KT 249 bazohet në punën për adoptimin e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare si standarde shqiptare, duke bashkëpunuar me KT "pasqyrë" të CEN dhe ISO si më poshtë:

CEN/TC 155 Sistemet e tubacioneve plastike dhe sistemet e kanalizimeve
 CEN/TC 249 Plastikë
 CEN/TC 266 Depozitat termoplastike të palëvizshme
 CEN/TC 366 Materialet e përpunuara të gomës
 ISO/TC 61 Plastika
 ISO/TC 138 Tubat plastike, pajisjet dhe valvolat për transportimin e lëngjeve

	Emri i institucionit: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT	Dokumenti Nr.: RC/DS/117	
Titulli: Plani strategjik i biznesit për DPS/KT	Versioni: 01	Faqe Nr.: Faqe 3/3	

F Planifikimi

Për realizimin e objektivave të më sipërme ky KT bazuar në propozimin e standardeve të reja fillon punën për adoptimin e standardeve.

G Financimi

Kryetari dhe anëtarët punojnë mbi baza vullnetare dhe pa pagesë.

Sekretari i DPS/KT 249

(Elona TELULI)